

## Fetah (Safer) Behrami

(24.03.1944, shqiptar nga Kaçandolli/Kaçandol, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, minator, tetë fëmijë)

## Jashar (Fetah) Behrami

(28.05.1969, shqiptar nga Kaçandolli/Kaçandol, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, një fëmijë)

Në datën **15.09.1998**, rreth orës 9:00, kishin rënë predhat e para në fshatin **Kaçandoll/Kaçandol**. Mjegulla ishte tërhequr dhe Fetahu dhe anëtarët e tjerë të familjes kishin parë se një granatë i kishte qëlluar pesë ushtarë të UÇK-së [të shikohet regjistrimin]. Ata vendosën që të strohoheshin në një bunker në afërsi të shtëpisë. Fetahu kishte mbetur i fundit. Bashkëshortja e tij e kishte dëgjuar zërin e tij dhe pastaj disa të shtëna nga drejtimi i shtëpisë. Të frikësuar, anëtarët e familjes së Fetahut dolën nga bunkeri dhe u nisën në drejtim të pyllit. Pasdite, rreth orës 16:00, i biri dhe vajza e Fetahut, janë kthyer në fshat për të marr ushqim. Në afërsi të shtëpisë kishin parë trupin e pajetë të babait të tyre. Fetahu u varros më 19.09.1998 në një arë, afër shtëpisë së tij. Në datën 20.09.1998, mbetjet mortore të tij familja i ka rivarrosur në varrezat e fshatit Kaçandoll/Kaçandol.

Po atë ditë, afro 300 metra larg shtëpisë së Fetahut, familjarët e gjetën trupin e pajetë të djalit të tij Jasharit. Askush nuk kishte parë se kur u kthye Jashari në fshat dhe në çfarë rrethana e humbi jetën. Familjarët, po atë ditë, e varrosën atë në varrezat, ku është i varrosur edhe babai i tij.

**Burimet:** deklarata H.B, FDH-11726; *More Victims Identified After Serb Leave Some of Villages of Podujeva*, pasqyra e lajmeve, KIC, 18.09.1998, FDH-29565.

## Ramadan (Sefer) Behrami

(1.01.1940, shqiptar nga Kaçandolli/Kaçandol, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, bujk, dymbëdhjetë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

## Musa (Selim) Begu

(19.10.1969, shqiptar nga Kaçandolli/Kaçandol, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, pjesëtar i UÇK-së)

Ramadani dhe Musa u vranë në datën

**15.09.1998**, gjatë luftimeve me forcat serbe në fshatin Kaçandoll/Kaçandol. Trupat e tyre të pajetë i ka gjetur kushëriri i Ramadanit, Fadil Jonuzi, në vendin e quajtur *Majat e Shtizës/Ostro koplje* [**Kaçandoll/Kaçandol**]. Ata u varrosën më 26.09.1998 në varrezat në Kaçandoll/Kaçandol.

**Burimet:** deklarata M.B, FDH-18115; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHFUDUÇK, *Feniksët...9*, 176 - 179, FDH-28372.

## Elez (Elez) Begu

(3.03.1943, shqiptar nga Kaçandolli/Kaçandol, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, minator, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Elezi para lufte punonte në Minierën *Trepça/Trepça*. Jetonte në fshatin Kaçandoll/Kaçandol, me bashkëshorten dhe dy djemtë e tij. Aderoi në UÇK në vitin 1997. Në mëngjesin e datës **15.09.1998**, kur forcat serbe e nisën sulmin kundër fshatit **Kaçandoll/Kaçandol**, Elezi me njësitin e vet gjendeshin në fshat. Trupin e tij të pajetë e gjeti i biri Riadi, i cili më 19.09.1998, pas tërheqjes së forcave serbe, me njësitin e vet të UÇK-së kanë hyrë në fshat. Babanë e varrosi po atë ditë, afër shtëpisë. Pas lufte, në prill të vitit 2000, mbetjet mortore të Elezit u rivarrosën me nderime ushtarake në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Kaçandoll/Kaçandol.

**Burimet:** deklarata R.B, FDH-33966; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor FDH-29762.

## Xhafer (Lam) Ajvazi

(20.05.1940, shqiptar nga Podujeva/Podujevo, mësues, gjashtë fëmijë)

## Muhamet (Mehmet) Fazliu

(15.06.1962, shqiptar nga Dumnica e Poshtme/Donja Dumnica, komuna e Podujevës/Podujevo, automekanik, tre fëmijë)

## Ejup (Idriz) Sejdiu

(14.08.1962, shqiptar nga Dobratini/Dobrotin, komuna e Podujevës/Podujevo, punëtor, një fëmijë)

## Rrahim (Bejtë) Ramadani

(19.02.1982, shqiptar nga Dobratini/Dobrotin, komuna e Podujevës/Podujevo, nxënës)